

Emër mbiemër: **Valter Memisha**  
Datëlindja: **1955**  
Vendlindja: **Tepelenë**  
Viti i zgjedhjes: **2023**  
Seksioni: **Shkenacat shoqërore dhe albanologjike**  
Gjuhët: **anglisht, rusisht**



---

## Kontakt

Adresa e punës: **Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Sheshi “Nënë Tereza”, Nr. 3, Tirana, Albania**

E-mail: **memisha\_valter@yahoo.com**

Faqja zyrtare **www.asa.edu.al / info@asa.edu.al**  
**www.akad.gov.al**

---

## CV e shkurtër

Ka kryer studimet e larta me rezultate shumë të mira në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, dega Gjuhë shqipe dhe letërsi (1974 – 1979; ka kryer studimet pasuniversitare me rezultate të shkëlqyera për gjuhës shqipe, pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës ( 1984-1985); ka mbrojtur *doktoratën* në gjuhësi (1997) dhe ka fituar titujt *Profesor i asociuar* (2002), *Profesor* (2011) dhe *Akademik* (2023).

Ka punuar si mësues i gjuhës shqipe dhe i letërsisë në rrethin e Tepelenës (1979-1989) dhe si pedagog i gjuhës shqipe në Institutin e Lartë Pedagogjik / Universiteti “E. Çabej”, Gjirokastër (1989 deri në vitin 2001). Punon pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2001-2007), dhe pas kësaj periudhe pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë (2008-sot).

Puna e tij shkencore lidhet me *fjalën shqipe* dhe për *fjalën shqipe*. Është leksikolog, semantolog dhe leksikograf. Ka marrë pjesë në mbi 15 ekspedita në Shqipëri dhe Kosovë për grumbullimin e fjalës shqipe.

Pjesëmarrës në disa projekte kombëtare leksikografike institucionale: në *Fjalorin e gjuhës shqipe*, 2006; bashkautor në *Fjalorin e vogël të gjuhës shqipe* 2002; në *Fjalorin e madh të gjuhës shqipe* (në proces hartimi).

Ka botuar 2 monografi, 7 përmbledhje me artikuj studimorë, 2 fjalorë dhe 1 tekst universitar. Ka marrë pjesë me kumtesa në mbi 160 veprimtari kombëtare e ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit (duke përdalluar me kumtime, sidomos në Kosovë e Maqedoninë e Veriut); ka organizuar 10 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Aktualisht po punon në disa projekte kombëtare.

Ka vazhduar pa ndërprerje veprimtarinë akademiko-mësimdhënëse universitare, me ligjërata në nivel bachelor, master shkencor dhe doktoraturë në disa universitete të vendit, si në Universitetin e Tiranës, në Universitetin e Gjirokastrës, në Universitetin e Elbasanit, në Universitetin Vlorës, në Qendrën e Studimeve Albanologjike / Akademia e Studimeve Albanologjike, në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhëve, Shkup etj. Ka drejtuar dhjetëra studentë në

master shkencor dhe 20 doktorantë, me punime nga fusha e leksikologjisë, e semantikës dhe e leksikografisë.

Ka qenë në organet drejtuese në Universitetin e Gjirokastrës (përgjegjës departamenti dhe dekan i Fakulteti të Shkencave Shoqërore), të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (përgjegjës departamenti dhe 9 vjet drejtor i këtij institucioni), ka qenë kryeredaktor i revistës “S. Filologjike” për 9 vjet dhe është anëtar i redaksisë së kësaj reviste, si dhe anëtar i redaksisë së revistës “Albanian studies”. Aktualisht është zëvendësrektor i Akademisë së Studimeve Albanologjike, kryetar i Komisionit të Gjuhës dhe të Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, anëtar i Këshillit ndërkademiç për shqipen, si dhe anëtar i Komitetit Shkencor të Leksikografëve të Evropës.

---

## **Publikime (monografi, studime, vepra të ndryshme të botuara)**

### **A. Vepra institucionale kombëtare**

1. Bashkëhartues në *Fjalorin e gjuhës shqipe*, 2006 (48.000 fjalë e 5.000 njësi frazeologjike);
2. Bashkëhartues në *Fjalorin e vogël të gjuhës shqipe* 2002 (35.000 fjalë e 3.000 njësi frazeologjike);
3. Bashkëdrejtues, zëvendëskryeredaktor, sekretar shkencor, redaktor dhe hartues në *Fjalorin e madh të gjuhës shqipe* (me 100.000 fjalë e njësi frazeologjike, në proces hartimi).

### **B. Vepra vetjake**

1. *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, (monografi) Gjirokastrë, 1999.
2. *Emërtime në Labëri për kafshë e shpendë* (fjalor), Gjirokastrë, 2001
3. *Emërtimet e shkurtuara në gjuhën shqipe* (monografi dhe fjalor me bashkautor), Tiranë, 2008
4. *Studime për fjalën shqipe*, I (Përmbledhje artikujsh e studimesh), Tiranë, 2011. ISBN: 978-9928-401-59-5
5. *Studime për fjalën shqipe*, II (Përmbledhje artikujsh e studimesh), Tiranë, 2015. ISBN: 978-9928-141-42-2
6. *Studime për fjalën shqipe*, 3 (Përmbledhje artikujsh e studimesh) ISBN 978-9928-141-67-5, Tiranë, 2017, (394 f., formati 205x150)
7. *Studime për fjalën shqipe*, 4, Tiranë, (Përmbledhje artikujsh e studimesh) ISBN 978-9928-289-38-8, Tiranë, 2019
8. *Leximi leksikografik i veprës “Shënime nga Shkolla e Partisë” e D. Gumenit*, ISBN 978-9928-289-28-5 Tiranë, 2019
9. *Studime për fjalën shqipe*, 5 (Përmbledhje artikujsh e studimesh), Tiranë, 2021, ISBN 978-9928-289-68-1
10. “*Studime për fjalën shqipe*”, 6 (Përmbledhje artikujsh e studimesh) Tiranë, 2021, ISBN 978-9928-289-68-8
11. V. Memisha, “*Studime për fjalën shqipe*”, 7 (Përmbledhje artikujsh e studimesh), ISBN 978-9928-289-87-2, Tiranë, 2022
12. V. Memisha, *Ushtrime për leksikologji e semantikë leksikore* (tekst universitar), Tiranë, 2012, ISBN: 978-99956-13-60-0